



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1204/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Tefik Maksuti, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Gjilan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Tefik Maksuti kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjilan, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:12 nga Tefik Maksuti kandidat për anëtar të kuvendit komunal, ku ka pretenduar se në fshatin Zhegër, përkatësisht në këto vend votime:

0409D/01R – mungojnë katër (4) vota,

0409D/02R - mungojnë tri (3) vota,

0409D/03R - mungojnë katër (4) vota,

0409D/04R - mungojnë zero (0) vota,

0409D/05R - mungojnë zero (0) vota,

0409D/06D - mungojnë tri (3) vota.

Ankuesi pretendon se gjatë një bisede me vëzhguesin Xhelil Rahmani njoftohet se i kanë figuruar 85 vota ndërsa në publikimin e rezultateve nga KQZ-ja i figurojnë vetëm 14 vota në fshatin Zhegër, thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit Tefik Maksuti për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi bindëse me qëllim të vërtetimit të shkëljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa

vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1204/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.